



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 35/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtares e lartë ligjore, Antigona Murati duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA, dega në Prishtinë, për shkak të shfrytëzimit të veturës zyrtare në tubim elektoral për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2017, mori këtë:

VENDIM

LEJOHET tërheqje e ankesës e Institutit Demokratik të Kosovës-KDI, Anr. 35/2017 05.06.2017.

Arsyetim

Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP kundër Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA, dega në Prishtinë, për shkak të shfrytëzimit të veturës zyrtare në tubim elektoral për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pasi që ankesa ka qene e paqarte, PZAP-i ka kërkuar nga parashtresesi i ankese qe te beje plotësimin e ankesës.

Me datë 02.06.2017 ankuesi ka parashtuar kërkesë për tërheqjen e ankesë me numër:Anr.35/2017, duke u bazuar në faktin se KDI nuk ka prova shtesë për ti ofruar PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP – i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 35/2017 më datën 05.06.2017.

